



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN
NR.7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

SHKËLQIM CANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2015

PËR

**NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Pas paragrafit të katërt, të nenit 9, “Llojet e kontributeve për t’u paguar”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes të kontributeve si dhe kriteret e përcaktimit të saj, deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2016.

K R Y E T A R I

ILIR META